



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 30.05.2025
Numër Protokolli: 3669/2025

A.nr.686/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.686/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.P. nga Pristina, kundër Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.686/2025, e datës 22.04.2025, e parashtruar nga ankuesi M.P.
- II. Shfuqizohet** Njoftimi i datës 01.04.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore, për shpalljen e kandidatëve fitues, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit me shifër RN00016564 për Grupin Ligjor, pozita “*Zyrtar i lartë ligjor*”, e shpallur nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.
- III. Obligohet** Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, M.P (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 18.04.2025, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila është regjistruar me datë 22.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën shenjë A.nr.686/2025, kundër Njoftimit të datës 01.04.2025 për kandidatët fitues në procedurën e rekrutimit me shifër RN00016564, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, i shpallur nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek KKTK, ndërsa kjo e fundit, me datë 08.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2605/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 22.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 01.04.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Konkursin e datës 30.01.2025; Njoftimin e rezultatit të testit me shkrim; E-mailin e datës 18.04.2025 dërguar në Këshill nga ankuesi; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 08.05.2025; Aplikacioni i kandidates G.V të datës 05.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidatit G.Sh të datës 03.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates E.Sh të datës 25.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates E.H të datës 31.01.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates A.H të datës 20.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidatit A.B të datës 06.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates V.S të datës 03.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates V.S-B të datës 25.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e ankuesit të datës 04.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 12.01.2010; Shkresë e datës 01.05.2021 lëshuar nga Kryetari i Komunës së Preshevës; Aplikacioni i kandidates Xh.M të datës 10.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formulari i renditjes përfundimtare i datës 28.03.2025; Formularët e vlerësimeve individuale të kandidatëve në intervistë të datës 28.03.2025; Testet me shkrim; Korrespondencë nëpërmjet emailleve; Njoftimi e datës 01.04.2025 për kandidates e suksesshëm; Njoftimin e datës 05.03.2025 për rezultateve e verifikimit paraprak; Aplikacioni i

kandidatit L.P të datës 14.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidatit L.B të datës 03.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i kandidates së suksesshme D.B të datës 27.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 27.05.2021; Letë reference të lëshuar nga Fondi për Të drejtën Humanitare në Kosovës i datës 24.08.2020; Vërtetimin e lëshuar nga kompania Aktiv Sh.P.K i datës 01.11.2022; Çertifikatë e lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës i datës 18.04.2023; Vërtetimin datës 27.12.2023 lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit hapësinor të Kosovës; Aplikacioni i kandidates së suksesshme J.A të datës 21.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, më datë 30.01.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016564, për Grupin Ligjor, pozita “Zyrtar i Lartë Ligjor- Profesional 1”, në kuadër të Zyrës së Udhëheqësit Ekzekutiv të Sekretariatit të KKTK-së, ku afati për aplikim ka qenë nga data 31.01.2025 deri më 0103.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 16 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi.

Tutje, ankuesi i është nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa sipas Formularët të datës 28.03.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, rezulton se ankuesi dhe 2 kandidatë të tjerë e kanë kaluar pragun minimal prej 70 pikësh për tu vlerësuar si kandidatë të suksesshëm siq përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga nenin 11 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si në vijim: “*Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat*”, respektivisht ankuesi ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 75.4 pikë, (prej tyre 51 pikë në testin me shkrim, ndërsa 24.4 pikë në intervistë me gojë), kandidatja B.Sh-R ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 77.2 pikë, (prej tyre 54.6 pikë në testin me shkrim, ndërsa 22.6 pikë në intervistë me gojë), dhe kandidatja D.B ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 90.4 pikë, (prej tyre 64.4 pikë në testin me shkrim, ndërsa 26 pikë në intervistë me gojë), prandaj thënë si më lartë, Njësia e Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë me datë 01.04.2025, ka publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, nga rezulton se kandidatja me më së shumti pikë rezulton të jetë D.B me gjithsejtë 90.4 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli, kundër Njoftimit të datës 01.04.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se procedura përkatëse e rekrutimit është përcjellë me shkelje të ligjit material dhe shkeljeve procedurale, të njëjtit i është bërë e pa drejtë, respektivisht pretendon se vlerësimi i testimit nuk ka qenë objektiv nga ana e Komisionit të Pranimit, po ashtu pretendon se Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me dispozitat nga neni 20 paragrafi 2 dhe 3, të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, sikurse përcaktohet se: “ 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues

të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse. 3. Për secilin nga kategoritë e anëtarëve të Komisionit, caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor” pasi që anëtarët kanë qenë të gjithë udhëheqës, dhe nuk ka pasur zyrtar të kategorisë profesionale të fushës përkatëse, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit ndërsa të anulojë konkursin e datës 30.01.2025.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim të konstatimit nëse procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me RN00016564, për Grupin Ligjor, pozita “Zyrtar i lartë ligjor” ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **“Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Juridik. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.”**,

Para se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dosjen e kandidates së suksesshëm të bashkangjitur përmes aplikacionit me rastin e aplikimit në konkurs me datë 20.02.2025, dhe konstatoi se e njëjta posedon Diplomën e datës 27.05.2021 me numër:7464 përmes së cilës dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet themelore me datë 05.05.2021 në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, andaj Kolegji i Këshillit duke marr për bazë faktin se përvoja e punës profesionale llogaritet vetëm përvoja e punës e fituar pas diplomimit, rrjedh se ankuesja pas datës së diplomimit 05.05.2021 nuk i ka dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura e rekrutimit sikurse është përcaktuar në konkursin e datës 30.01.2025, pasi që lidhur me përvojën e punës posedon Vërtetimin e datës 01.11.2022 lëshuar nga Aktive Sh.P.K përmes të cilit pasqyrohet fakti se ankuesja ka punuar në këtë kompani për gjashtë (6) muaj, nga data 01.09.2021 deri me datë 28.02.2022 në pozitën e juristes, mirëpo kjo dëshmi e përvojës së punës nuk është mbështetur me prova shtesë sikurse përcaktohet në pikën 5 të konkursit të datës 30.01.2025 **“Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre-Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal”**, posedon Çertifikatën e datës 18.04.2023 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, sipas së cilës dëshmohet fakti se e njëjta ka kryer punë praktike prej 1 viti, nga data 14.04.2022 e deri me datë 13.04.2023, po ashtu posedon Vërtetimin e datës 27.12.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes të cilit pasqyrohet fakti se e njëjta ka kryer praktikën edhe në këtë institucion në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajsh, nga data 01.04.2023 e deri me datë 31.12.2023, mirëpo Kolegji i Këshillit thekson fakti se përvoja e praktikës mundë të zgjatë maksimalisht vetëm një (1) prandaj në rrethanat e rastit konkret vetëm një (1) vit i përvojës së punës praktike i llogaritet të cilën e kishte realizuar në Sekretariatin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, gjegjësisht një çështje e tillë është rregulluar edhe me kuadrin ligjor në fuqi, Ligjin nr.03/L-212 i Punës nenin 16, paragrafi 1, 2 dhe 4 ku përcaktohet se: **“1. Punëdhënësi mund të lidhë Kontratë Pune me praktikantin. 2. I**

*punësuar në cilësinë e praktikantit i cili ka lidhur kontratë pune me punëdhënësin, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit e tjerë, 4. **Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj.**”, prandaj thënë si më lartë Kolegji i Konstatoi se kandidatja e suksesshme nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale prej dy (2) vitesh, i cili ka qenë parakusht sikurse është përcaktuar në konkursin e datës 30.01.2025, ashtu që ankuesja ka vetëm një (1) vit të përvojës së punës profesionale pas diplomimit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ngase lidhur me përvojën e punës në Kompaninë Aktive Sh.P.K nuk ka ofruar dëshmi shtesë (pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal) sikurse ishte përcaktuar në konkurs, ndërsa përvoja e punës në cilësi të praktikantes prej nëntë (9) muajsh në Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk mund t’i pranohet si përvojë e punës profesionale shtesë, pasi që çështja se sa mund të zgjas maksimalisht puna praktike, është rregulluar me Ligjin e Punës, të përcaktuar si në dispozitën e cekur si më lartë.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit analizoi edhe aplikacionin e ankuesit me dokumentacionin bashkangjitur me rastin e aplikimit dhe konstatoi se, ankuesi posedon Diplomën e datës 12.01.2010 përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti me datë 08.07.2009 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës, kurse si dëshmi të përvojës së punës ka bashkangjitur Shkresën e datës 01.05.2021 me shifër:137/21 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Preshevës, përmes së cilës konfirmohet fakti se ankuesi ka punuar në Komunën e Preshevës në pozitën “Zëdhënës i Komunës së Preshevës” në kohëzgjatje nga data 01.08.2018 e deri me datë 30.04.2021, mirëpo Kolegji i Këshillit thekson faktin se përvoja e punës profesionale në konkursin e datës 30.01.2025 është kërkuar në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, dhe mbi këtë bazë konstatoi se i njëjti nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale, pasi që konkursi në fjalë ka qenë i hapur për pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, ndërsa i njëjti si përvojë pune ka paraqitur përvojën në pozitën e Zëdhënësit të Komunës së Preshevës, e cila nuk është në fushën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për themelimin e Komisionit të Pranimit, Kolegji i këshillit u bazua në Vendimin Nr.12/2025 të datës 06.03.2025 përmes të cilit Zv. Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore e ka themeluar Komisionin e Pranimit në përbërje prej pesë (5) anëtarësh, si në vijim: 1. H,Q-Udhëheqëse e Divizionit të Bashkëpunimit në Agjencinë Shtetëror të Arkivave, Kryesuese, 2. A.P- Udhëheqë i Divizionit Gjuhësor në Zyrën e Kryeministrit, anëtar, 3. M.U-Udhëheqë i Divizionit për Zbatim të Legjislacionit, anëtar, 4. A.H-Udhëheqë i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme-KKTK, anëtar, dhe 5. B.R-U.D Udhëheqë i Divizionit të Burimeve Njerëzore në KKTK, anëtarë, dhe mbi këtë bazë konstatoi se Komisioni i pranimit është themeluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 20 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, sikurse përcaktohet se: " 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i

kategorisë profesionale i fushës përkatëse. 3. Për secilin nga kategoritë e anëtarëve të Komisionit, caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor”, ngase që të gjithë anëtarët kanë qenë të nivelit drejtues, ndërsa norma në fjalë ka përcaktuar se në mesin e anëtarëve të komisionit përkatës, vetëm tre (3) anëtarë duhet të jenë të nivelit të mesëm apo ulët drejtuese, sikurse në përbërjen e komisionit nuk ka pasur të caktuar asnjë zyrtar të kategorisë profesionale të fushës përkatëse dhe po ashtu komisionit në fjalë nuk i janë caktuar anëtarët zëvendësues, sikurse përcaktohet në rregullore, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Prandaj, thënë si më lartë Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *“1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit”, dhe se konkursi me numër reference RN00016564, për grupin ligjor, pozita “Zyrtar i Lartë Ligjor- Profesional 1”, në kuadër të Zyrës së Udhëheqësit Ekzekutiv të Sekretariatit të KKTK-së, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 20 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ndërlidhur me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që kandidatja e suksesshme sikurse edhe ankuesi nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kriterin e përvojës së punës profesionale prej dy (2) vitesh, sikurse ishte përcaktuar në konkursin e datës 30.01.2025, dhe po ashtu Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara si në arsyetimin e këtij vendimi.*

Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoi të gjeturat e theksuara si më lartë, nuk u lëshuar në shqyrtimin e aplikacioneve të 16 kandidatëve të tjerë që e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak sipas Njoftimit të datës 05.03.2025, me qëllim të konstatimit nëse të njëjtit i kanë plotësuar kriteret e konkursit apo jo, pasi që një fakt i tillë nuk do ta ndryshonte natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, pasi që janë konstatuar shkelje esenciale të parimeve të pranimit në shërbimin civil, andaj ankesa e ankuesit u aprovua vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në këtë vendim, ndërsa Kolegji i Këshillit vendosi të shfuqizoi Njoftimin e datës 01.04.2025 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për shpalljen e kandidatës së suksesshme dhe të anuloi në tërësi procedurën e rekrutimit RN00016564 për Grupin Ligjor, pozita “Zyrtar i Lartë Ligjor”, sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se me rastin e vendosjes në këtë çështje administrative pati parasysh dispozitat e aplikuara nga nenin 132 paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“ Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj”,* mirëpo Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuara të kuadrit ligjor në fuqi të ligjit material, ku përcaktohet qarte se kandidatët për pranim në shërbimin civil duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara të konkursit të specifikuar me aktet ligjore në fuqi, dhe për rrjedhojë pavarësisht faktit që ankuesi ishte përfshirë në listën e ngushtë, Kolegji i Këshillit vendosi si në

dispozitivin e këtij vendimi të mbështetur në arsyetimin përkatës të dhënë si më lartë, dhe përveç tjerash ankuesi e kishte kërkesë në petitumin e ankesës së tij të datës 22.04.2025, që Këshilli ta anuloi konkursin në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 4 dhe 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.686/2025, datë 30/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.P;
- Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (Udhëheqësit Ekzekutiv, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.